

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“MEGACONS” sh.p.k

Tiranë më datë 08/04/2021

NENI 1

Shoqëria Tregtare **“MEGACONS” sh.p.k** (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

NENI 2

Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **“MEGACONS” sh.p.k**

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ndërtimin e veprave civile, tuneleve, rugeve, autostradave, dhe çdo lloj tjetër të veprave civile.

Konkretisht:

1. Projektimet dhe ndërtimet të karaktereve të llojeve të ndryshme
2. Prodhimi i materialeve të ndërtimit, inerteve, betonit, parafabrikatëve të betonit, prodhimin e asfalti
3. Zhvillimin dhe kryerjen e aktivitetit të shërbimeve, konsulencës dhe studimeve të projekteve të çdo lloji.
4. Realizimin e kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo firma të tjera të lejuara nga ligji



Shoqëria mund të ushtrojë çdo lloj aktiviteti tregtar që legjislacioni i Republikës së Shqipërisë nuk e ndalon.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga e Barrikadave; Qendra Turdiu; K2; N17, Tiranë, Shqipëri.**

NENI 5



Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën **100.000 (njeqind mijë) lekë**.

Kapitali ndahet në 3 (tre) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

- 1. z. Christof Schotte**, lindur më 23.03.1966, në Oostende, Belgjikë i Shtetësisë Belge, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Pasaportës nr. EP486352, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 30 % të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1 (një) kuotë me vlerë **30.000 (tridhjetë mijë) Lekë**.
- 2. z. Dritan Meminaj**, lindur më 07.02.1971, në Belishovë, Shqipëri i Shtetësisë Shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Kartës së Identitetit nr. H10207120N personal, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 35 % të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1 (një) kuotë me vlerë **35.000 (tridhjetë e pesë mijë) Lekë**.
- 3. z. Tryfon Tzelis**, lindur më 18.08.1968, në Patra, Greqi i Shtetësisë Greke, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Pasportës nr. AN396947 personal, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 35 % të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1 (një) kuotë me vlerë **35.000 (tridhjetë e pesë mijë) Lekë**.

Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortakut themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është nënshkruar nga Ortakët Themelues.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7


Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rigjedhjeje.



Administratori i parë i shoqërisë është **z. Dritan MEMINAJ**, lindur më 07.02.1971 në Belishovë, Fier, Shqipëri, shtetas Shqiptar, identifikuar nëpërmjet ID me nr. H10207120N, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit për të drejtën dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtësinë e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13


Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT


Christof Schotte

Christof Schotte

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Christof Schotte', written over a horizontal line.


Dritan Meminaj

Dritan Meminaj

A large, stylized handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Dritan Meminaj', written over a horizontal line.

Tryfon Tzelis

TRYFON TZELIS

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Tryfon Tzelis', written over a horizontal line.